

FATON BISLIMI

Programi për

LDK-në

e

Vlerave Themeltare

dhe

Idealeve Kombëtare

Prishtinë, Nëntor 2023



Të dashur miq e dashamirë,

Të nderuar njerëz të mirë të LDK-së,

Të nderuar Delegatë të Kuvendit të Dhjetë Zgjedhor të LDK-së,

Më 13 nëntor 2023, kam njoftuar Kryesinë e LDK-së në Prishtinë, përmes një shkrese zyrtare, se në bazë të Nenit 8.1, Nenit 16.2 dhe Nenit 25, të Statutit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kam vendosur që në Kuvendin e Dhjetë të LDK-së që do mbahet më 19 nëntor 2023, do të paraqes para delegatëve kandidaturën time për Kryetar të LDK-së.

Unë besoj fuqishëm në LDK-në e vlerave themeltare dhe idealeve kombëtare të trasuara nga Presidenti Rugova.

Ky vendim imi vjen jo vetëm si vazhdimësi e angazhimit tim për vendin dhe gatishmërisë për t'i shërbyer familjes së madhe të LDK-së së vërtetë, por edhe si përgjigje ndaj krejt atyre që kanë filluar të humbin shpresën për një LDK që kishin dashur e kanë aspiruar, si dhe atyre që asnjëherë nuk rreshtën së përkrahuri vizionin e përpjekjen time për LDK-në.

Siç e pata theksuar edhe në letrën time të dorëheqjes nga Kryesia e LDK-së më 24 maj 2023 (e cila nga eksponentë të caktuar u mundua të paraqitej rrejtshëm si dorëheqje e imja nga LDK-ja), unë kam vazhduar të kem vizion të palëkundur për një LDK që i qëndron besnike vlerave rugoviste, për një LDK që shpërfaqë e praktikon djathtëzmit autentik kombëtar si dhe një LDK që e sheh secilin aktivist e aktiviste, të mëparshëm apo të tanishëm, si hisedarë e jo si shërbëtorë të partisë. Si atëherë, ashtu edhe tani, unë zgjedh LDK-në e idealeve dhe pragmatizmit politik, jo atë të interesave personale e grupe; LDK-në e atyre që sakrifkuan e nuk u lodhën asnjëherë së punuari për liri, demokraci e pavarësi; LDK-në e vlerësimit dinjitoz të figurave themeltare e të të rënëve të saj; LDK-në e miqësisë permanente me SHBA-të; dhe mbi të gjitha, LDK-në e aktivistëve e kontributdhënësëve, jo atë të titullarëve! Për këtë LDK, ofroj gjithëçka nga vetja ime!

Dorëheqja ime nga Kryesia ishte akt moral dhe paralajmërim i drejtpërdrejtë që rruga që kishte zgjedhur LDK-ja nën këtë udhëheqësi ishte e papranueshme dhe në kundërshtim me vlerat themeltare dhe idealet kombëtare për të cilat do duhej të qëndronte LDK! Tani që po i afrohem Kuvendit të Dhjetë Zgjedhor, po afrohet edhe momenti i mundësisë së rikthimit të LDK-së tek këto vlera e ideale!

Në një kohë kaq kruciale për shtetin tonë, LDK-ja ka rol esencial dhe historik, ashtu siç kishte në të kaluarën kur ishte bërë kurriz i ruajtjes së qenjes kombëtare shqiptare në Kosovë, si dhe themel i procesit të shtetndërtimit, lirisë e pavarësisë. Sukseset më të mëdha e më meritore të LDK-së janë shënuar kur ajo është udhëhequr nga dashuria vetmohuese për shtetin.

Sot, janë të panumërt njerzit e mirë të LDK-së që ndjehen të papërfaqësuar nga LDK e anatemuar jo vetëm ideologjikisht por edhe praktikisht. Ka një armatë të tërë aktivistësh e kontributdhënësish – që nga kohët më të vështira – që janë të pakënaqur me drejtimin e LDK-së e tanishme. Ka shumë figura emblematike që asnjëherë nuk iu dha as respekti dinjitoz e i merituar.

Unë besoj në vlerat e përbashkëta që duhet të ofrojë LDK-ja. Besoj dhe angazhohem për secilin që e sheh LDK-në si strumbullar të zhvillimeve pozitive për shtetin dhe kombin. Besoj në vendin meritator dhe vlerësimin adekuat që duhet dhënë për secilin që nuk kurseu asgjë nga vetja për të mirën e vendit përmes LDK-së. LDK-ja e vërtetë është ndërtuar e mbajtur nga puna vullnetare e aktivistëve të saj, nga kontributdhënësit e përkrahësit pa asnjë kusht, nga ai mësuesi e ajo mjekja që punonin pa kompenzim, nga ai ushtari i lirisë që luftën e bënte për shtet e jo për pushtet, nga ata mërgimtarët tanë që ndanin jo vetëm kafshatën e gojës por edhe gjithëcka tjetër që u kërkohesh, vetëm e vetëm për ta mbajtur në këmbë idenë e shtetit të lirë e të pavarur të Kosovës. E kjo ide ishte frymëzimi i krejt Kosovës. Kjo ide e lirisë e pavarësisë, anipse fillimisht dukej e pamundur, u bë realitet, u arritë nën leadershipin e Presidentit Rugova dhe njerëzve më intelektualë e të urtë të kohës, disa prej të cilëve, fatkeqësisht, u likuiduan mizorisht nga dorë e zezë antikombëtare edhe pas agut të lirisë.

LDK nuk rritet e ringritet duke anashkaluar, përjashtuar, e përbuzur, por duke përbashkuar, respektuar, e mirënjohur secilin që ndanë besimin për të.

Derisa të panjohurat e së nesërme na sjellin dilemat e tanishme, e kaluara na jep mësimet. Të frigohe mi nga shpërfaqja e bindjeve tona të përzemërta është të mohojmë vetën. Të ruajmë të mbyllura në vete qoftë kontradiktat apo edhe dashamirësitë është devijuese ndaj progresit njerëzor e po ashtu edhe politik. Në dallime e kundërshti nuk duhet ligështuar; përkundrazi, duhet frymëzuar. Të definohe mi nga ajo që na përbashkon është shumë më frutdhënëse sesa nga ajo që na dallon. Unitet në dallime – është vlera më e rëndësishme e busollës së orientimit tim politik. Andaj, 19 nëntori është shanci, ndoshta edhe i fundit, për ruajtjen e LDK-së se vlerave themeltare dhe idealeve kombëtare. Për secilin e secilin që përnjëmend ka besuar e beson në këto vlera e ideale, zgjedhja do jetë e lehtë atë ditë. Vetëm një LDK e tillë do të mund të sfidojë në mënyrë triumfaliste narrativën e atyre që përmes populizmit të skajshëm e pseudonacionalizmit kapën majat e pushtetit. E ky është shërbimi më i madh që do i bënim vendit, shtetit dhe gjeneratave të ardhëshme.

Bashkë, ia dalim. Po, mundemi! Mundemi sepse askush e asgjë nuk është më e fuqishme se bindja e besimi.

Ju falënderit!

P.S.

Në vijim, do ndaj me ju një përmbledhje të shkurtër të programit tim për LDK-në, si dhe disa shënime biografike.

FILOZOFIA POLITIKE,
VLERAT BAZË TË LDK-SË, DHE
REFORMA SI ZHVILLIM

DJATHTIZMI SI THEMEL I LDK-SË PËR TË MIRËN E VENDIT

Nuk ka intervistë apo deklaram publik të shumicës së pjesëtarëve të klasës politike të Kosovës, të cilët, të paktën në një fjali nuk merren pak me ideologjinë politike dhe zhargonin më të përmendur të saj, "të djathtën dhe të majtën." Por, a thua, sa thellë shkojnë bindjet tona politike sa i përket ndarjes së spektrimit politik në të majtë e të djathtë? Sa nga ne e kuptojnë mjaftueshëm cilësimin majtist e djathtist si dhe orientimin politik që këto terma nënkuptojnë?

Nëse pak i kthehemi historisë politike dhe ndarjes së spektrimit politik në këto dy drejtime bazike si linja të përkufizimit të themeleve ideologjike politike, atëherë shohim se sa më i rëndësishëm është botëkuptimi që ngërthejnë në vete këto definime sesa vec zhargonit. Por, historia politike na meson se ashtu sic kanë evaluuar me kohë bindjet politike, ashtu kanë evaluuar edhe djathtizmi e majtizmi politik. Ndasitë ideologjike nuk janë vetëm zhargoniste, por janë bindje që në asimetrinë e besimit politik përcaktojnë rrugëtimin e një force politike e përmes saj edhe të një shoqërie, shteti, e kombi.

Dikotomia e ndasisë ideologjike themeltare në të majtë e të djathtë buron nga Revolucioni Francez në verën e vitit 1789. Sipas profesorit të historisë moderne franceze, David Bell, nga Princeton University, pas rënjes së Bastilles, kuvendi francez po debatonte gjerë e gjatë mbi ndryshimet në kushtetutën e vendit dhe çështja me esenciale ishte nëse kushtetuta e re do t'i jepte të drejtën absolute të vetos mbretit (monarkut) apo jo. Ata që ishin përkrahës të idesë që kushtetuta e re duhej ti jepte të drejtën absolute të vetos monarkut ishin të ulur në të djathtë nga kryesuesi i kuvendit, kurse ata që besonin se kjo e drejtë nuk duhej t'i jepej monarkut, qëndronin të ulur në të majtë të kryesuesit. Këtu buron edhe varianti më bazik dhe themeltar i ndasisë ideologjike politike – në djathtistë, për ata që ruajnë dicka më tradicionale; dhe në të majtë, për ata që duan dicka më ndryshe, jotradicionale.

U dashtë mbi një shekull që zhargoni djathtist e majtist të bëhej diskursi primar i definimit të identitetit politik. Një ngritje e këtij definimi erdhi në pah me Bolshevikët në Rusi, të cilët kishin admirim të thellë për Revolucionin Francez dhe e shihnin sim undësi për ridefinimin politik të Ruisë asokohe, dhe përmes saj, të të gjithë botës. Sipas profesorit të kulturës evropiane dhe historisë intelektuale, Marci Shore, nga Yale University, identiteti politik i ndarë në dy pole shihej si hap i domosdoshëm në historinë e zhvillimit politik deri tek ardhja e komunizmit.

Mes-shekulli i njëzet dhe dy luftrat botërore radikalizuan skajshëm polet e identitetit ideologjik e politik në të majtë e të djathtë, dhe thuajse ia humbën komplet edhe vlerën e mesit apo qendrës liberale. Radikalizimi i këtyre poleve erdhi si pasojë e sforcimit të partive politike. Kur njerzit devijonin nga vijat politike të partisë, ata konsideroheshin 'ektremistë' apo 'radikalë.' Kjo shihet më së kjarti në kohën e Stalinizmit dhe ngritjen e Hitlerit.

Më pas, zhargoni majtist e djathtist u fut edhe në politikën amerikane në shekullin e njëzet. Sipas profesorit të politikës dhe lëvizjeve shoqërore në SHBA, Michael Kazin, nga Georgetown University, ishte programi zhvillimor "New Deal," i Presidentit Franklin D. Roosevelt i 1933 që i dha hov botëkuptimit më të vecantë në mes të së majtës – që kërkonte më shumë involvim shtetëror në shoqëri e ekonomi, dhe të djathtës – që sfidonte e nuk duronte thuaja aspak involvim shtetëror në shoqëri e aq më pak në ekonomi. Identiteti majtist në SHBA në atë kohë asocionte me lëvizjet komuniste e socialiste, kurse ai djathtist me konservatorizmin.

E sot, edhe pse terminologjia vazhdon të evoluojë për aq sa evoluonë politika botërore, djathtizmi ndërlidhet me konservatorizmin kurse majtizmi me progresivitetin. Këtu gjendet edhe themra e Akilit në këtë debat.

Çka do të thotë konservatorizmi në kuadër të botëkuptimit të identitetit ideologjik? Për djathtizmin, konservatorizmi është ruajtja e traditave. Kurse,

progresiviteti për majtizmin është ndryshimi i vazhdueshëm, modernizimi që shpeshëherë thyen, anashkalon, zhvlerëson, por edhe fundosë tradicionalen. Këto dy pole të spektrit të identitetit ideologjik politik janë oponente që zvogëlohet sa më afër qendres së spektrit. Andaj, shumica e partive politike por edhe e politikanëve pretendojnë të vendosin veten tek “të djathtë të qendrës,” apo “të majtë të qendrës,” ashtu që të sigurojnë besimin e sa më shumë njerëzve, ngase në ekstremet e poleve gjendet kryesisht pakicat elektorale.

Por, ajo që është esenciale për Kosovën, një shtet në ndërtim e sipër, një shtet i lindur nga një histori politike sui generis në rrjedhën e politikës globale të fundshekullit 20 e fillimshekullit 21, është ideologjia politike që duhet të ndjek ky vend për t’i siguruar vetën jo vetëm zhvillim por edhe qëndrueshmëri politike. Klasa politike e Kosovës, por edhe elektorati në përgjithësi, duhet të kuptojnë se ka vetëm një frymë ideologjike politike që e shpëton Kosovën si shtet nga gllabërimi eventual i përrhyerjeve të mëdha në politikën globale. Sipas Samuel Huntington, autorit të librit të famshëm “Përleshja e Civilizimeve dhe Fundi i Historisë,” linjat e ndarjes së civilizimit përendimor nga ai lindor bijnë pikërisht në Kosovë. Kjo e bënë edhe më kruciale nevojën e Kosovës për të pasur një casje jashtëzakonisht të saktë e në linjë me civilizimin që e dëshiron dhe beson se i takon – perëndimit. Këto parakushte parasysh, nuk ka se si mos të shohim se është vetëm djathtëzimi ai që e shpëton Kosovën.

Më specifikisht është djathtëzimi autentik kombëtar, si formë specifike e djathtëzimit si identitet ideologjik politik, që i siguron Kosovës ecjen drejt fianlizimit të procesit të shtetndërtimit dhe vendin meritore në familjen e kombeve perëndimore.

Pse djathtëzimi? Kjo besoj tanimë është kuptuar nga elaborimi i mësipërm i ndasisë në mes dy poleve ideologjike. Por, djathtëzimi na duhet ngase na e ruan tradicionalen, na e ruan vlerën tonë unike si komb autokton evropian.

Pse autentik? Djathtizmi, në historinë politike, është nënkuptuar sipas rrethanave politike të kohës dhe vendin. Botëkuptimi i tij ka ndryshuar që nga Revolucioni Francez e deri tek lëvizjet studentore në SHBA. Andaj, edhe në rastin e Kosovës, por edhe për shqiptarët në Ballkan në përgjithësi, djathtizmi autentik do të thotë djathtizmi që i shërben specifikave të shtetit tonë e kombit tonë. Djathtizëm që mban për themel konservatorizmin e vlerave tona tradicionale dhe ringritë ato në linjë me rrethanat e kohës.

Pse kombëtar? Djathtizmi autentik është djathtizmi që buron nga nevojat e një vendi të caktuar për një kohë të caktuar. Elementi kombëtar këtu është shumë esencial ngase problematika e shqiptarëve në Ballkan ka qenë gjithëherë problematike kombëtare e asnjëherë vetëm shtetërore – dmth vetëm e Shqipërisë, për shembull. Andaj, djathtizmi autentik kombëtar është identiteti i vetëm ideologjik që siguron trajektorën më të mirë për arritjen e qëllimeve tona kombëtare. Në shekullin e fundit, nuk ka arritje me të madhe për shqiptarët si komb sesa krijimi i shtetit të Kosovës. Sforcimi dhe qëndrueshmëria e këtij shteti ndërlidhen kryekëput me djathtizmin autentik kombëtar si identitet ideologjik.

Vetëm atëherë kur Kosova të arrijë stadin e zhvillimit demokratik e socio-ekonomik që i siguron asaj vendin meritë në familjen e kombeve perëndimore, ne mund të 'luftojmë' lirshëm përbrenda nesh, të ndarë në parti politike, e me identitet ideologjik në të dyja polet. Historia jonë kombëtare deri më tani na ka dhënë leksione të kjarra që tregojnë me fakte të pamohueshme ecjen tonë mbrapa saherë që në krye kemi pasë identitetin ideologjik majtist, dhe përparimin e vockël e të shkurtër sa herë që në krye kemi pasë identitetin ideologjik djathtist. Pasi që të kemi përfunduar me sukses procesin e shtetndërtimit të Kosovës, edhe mund të bëjmë eksperimente politike majtiste, por deri atëherë, duhet qenë shumë syhapur!

RUGOVIZMI – DJATHTIZMI AUTENTIK KOMBËTAR

Është djathtizmi autentik kombëtar, si formë specifike e djathtizmit si identitet ideologjik politik, që i siguron Kosovës ecjen drejt fianlizimit të procesit të shtetndërtimit dhe vendin meritator në familjen e kombeve perëndimore.

Por, nuk ka mendësi politike e veprim politik më shembullor sesa rugovizmi si djathtizëm autentik kombëtar. Rugovizmi, si mendësi e politikbërjes e aplikuar nga Presidenti Rugova as nuk ka ikë me shkuarjen e tij në amshim, por as nuk mund të tjetërsohet nga kushdo që zë pozitat politike të Rugovës qoftë në krye të partisë apo shtetit.

Për ta parë kjo si kristali se Rugova në veprimet e tij politike, si rezultat i bindjeve të tij djathtiste, ka trasuar djathtizmin autentik kombëtar në Kosovë, na duhet vetëm t'i kthehemi pak historikut të tij dhe politikbërjes së tij.

Zanafilla familjare e Rugovës është e djathtë, ngase edhe babai edhe gjyshi i tij ishin pushkatuar nga çetnikët jugosllave qysh më 1945. Familja e tij ishte familje patriotike anti-komuniste. Djathtizmi i tij dhe më pasë i rugovizmit si mendësi politike në spektrin e oscilimeve ideologjike veçohen pikërisht për shkak se janë verzioni më i mirë praktik i djathtizmit për Kosovën.

Pos trungut familjar, veprimtaria politike e Rugovës që fillon me themelimin dhe me marrjen e kryesimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës më 1989 jep argumentet shtesë në këtë kontekst. Këto argumente do t'i ndaja në tri grupe: 1. tradicionale/historike, 2. kombëtare/patriotike, dhe 3. identitare/orientuese.

1. Si kritik letrar, Rugova kishte arritur të mësonte shumë edhe për historinë e kombit tonë. I ndikuar intelektualisht nga Bogdani kryesisht, Rugova në mendësinë e tij politike i kishte rezervuar vend të posaçëm historisë sonë kombëtare dhe traditave shqiptare. Ishte pikërisht Rugova ai i cili riktheu emrin Dardani si alternativë për

shtetin e Kosovës, duke propozuar edhe flamurin shtetëror me simbole dardane. Tutje, ishte pikërisht Rugova që riktheu në praktikën tonë kulturore 'Darkën e Lamës,' si përbashkim rreth sofrës së bukës e si falënderim për bereqetin e arritur. Këto dy instanca janë shembuj klasik të rikthimit tek rrënjët, të sforcimit të vlerave historike e tradicionale për Kosovën.

2. Lidhshmëria e rezervë e Rugovës me shqiptarët edhe jashtë Kosovës – sidomos me mërgatën, por edhe me ata në Maqedoni, Mal të Zi, Luginë të Preshevës, e edhe në Shqipëri – përbën elementin shtesë të përqaqimit të kauzës kombëtare nga ana e tij, të parë përmes prizmit të demokracisë, lirisë dhe pavarësisë për Kosovën. Si lider politik i Kosovës, ai ngjalli shpresën për ditë më të mira edhe tek shqiptarët përreth Kosovës – nën hijen e tij politike u krijuan partitë e para demokratike të shqiptarëve në Luginë, në Maqedoni, e në Mal të Zi. Patriotizmi i pashembulltë i Rugovës u tregua edhe përbrenda vet LDK-së dhe Kosovës. Duke qenë se mendësinë e tij politike e udhëhiqte një kauzë më e madhe se vet ai, pra kauza kombëtare, strumbullar i së cilës ishte Kosova e lirë, e pavarur, dhe demokratike, Rugova nuk mëtonte asnjëherë të merrej me ata që merreshin me të. Këtë vendosshmëri të tij për t'i shërbyer kauzës kombëtare e jo pozitës apo personalitetit të tij, ai e tregoi disa herë, por ndër kryesoret janë kur ai i dha mundësinë Thaçit të udhëheqte delegacionin e Kosovës në Rambuje; apo edhe kur i dha mundësinë Haradinajt të bëhej Kryeministër anipse me vota ishte shumë large nga ajo pozitë. Këto instanca janë shembuj klasik të elementeve kombëtare/patriotike që përcaktonin veprimet e tija politike.

3. Qysh në filltet e politikës, Rugova kishte përcaktuar orientimin strategjik të Kosovës kah perëndimi. Në këtë kuadër, janë dy elemente kryesore që pasqyrojnë vlerat identitare të Kosovës dhe orientimin e saj perëndimor. E para, që ishte bërë edhe postulat politik në Kosovë, dhe mbetet e tillë sot e kësaj dite, ishte "miqësia permanente me SHBA-të." I gjendur në një kohë të ndryshimeve të mëdha ideologjike botërore si rënja e Murit të Berlinit, disintegroimi i BRSS-së, në njërën anë, dhe insistimi amerikan për përhapje globale të demokracisë në anën tjetër,

Rugova kishte bërë zgjedhjen e tij dhe këtë orientim strategjik të Kosovës nuk e lëshoi asnjëherë – sytë kah Amerika! Por, ka edhe një element tjetër këtu me rëndësi esenciale për vendin dhe trajektoren politike të Kosovës që e kishte përcaktuar Rugova: afërsia me Vatikanin. Për shumëkë, në princip, një lëvizje e fillë e Rugovës për të afruar Kosovën me Vatikanin dukej e pashije, për të mos thënë e gabueshme, kur dihet se shumica absolute e popullit të Kosovës janë të besimit islam. Por, gjenialiteti i një lideri shkëlqen kur ai arrinë të bëjë aleancat e jashtme (qofshin ato edhe jo të natyrshme në shikim të parë) pa dëmtuar në thelb kohezionin e brendshëm. Nuk ka shembuj më të mirë se këta dy për të parë se si elementet identitare/orientuese kishin rol themeltar në politibërjen rugoviste.

Marrë së bashku, këto tri grupe të argumenteve të elaboruara më lartë, plotësojnë mozaikun e djathtizmit autentik kombëtar. Nuk ka djathtizëm të mirëfilltë pa bazë të fortë në vlerat tradicionale, identitare, dhe patriotike të një vendi apo populli. Nuk ka djathtizëm autentik kombëtar pa një LDK përnjëmend rugoviste! Nuk ka Kosovë me shtetësi të sforcuar si duhet, dhe me vend meritor në familjen e kombeve perëndimore pa një forcë politike që me mish e me shpirt e përqafton, e beson dhe e implementon djathtizmin autentik kombëtar!

KONSERVATORIZMI POLITIK

Njëra prej shtyllave më të fuqishme dhe më përmbajtësore të një partie politike të djathtë (apo të qendrës së djathtë) është konservatorizmi politik. Konservatorizmi politik, në këtë kuadër, nuk do të thotë mosndryshueshmëri! Konservatorizmi politik si bosht kurrizor i një subjekti politik ruan trashëgiminë politike dhe sforcon vizionin për të ardhmen në linjë me principet themeltare mbi të cilat është ndërtuar subjekti në fjalë. Ndryshimet janë të domosdoshme. Ato paraqesin trajtën e domosdoshmërisë së rrethanave në trajektoren drejtë përmbushjes së misionit e vizionit politik në secilën kohë.

Por, konservatorizmi politik rëndohet e bile edhe dëmtohet, kur ndryshimet që bëhen janë më shumë kozmetike sesa substanciale, më shumë të interesit personal sesa të interesit politik partiak. Goditja më e fortë që i bëhet konservatorizmit politik është implementimi i standardit të dyfishtë të ndryshimit. Kur ky standard bëhet instrument për fortifikim pozitash apo trumpetim lavdije të pabazë për individë të subordinuar, atëherë subjekti politik, në dukje rigjenerohet, por në përmbajtje vyshket!

Të cënosh konservatorizmin politik të një subjekti politik të djathtë (të qendrës së djathtë) është të godasësh boshtin kurrizor të tij. Sa më e madhe kjo goditje, aq më i thellë dëmi—dëm ky, shpeshëherë, i pariparueshëm.

Vlerat e bazuara në profesionalizëm e kontribut politik duhet shpërblyer. E ato vlera rriten kur të tjera iu bashkangjiten vetëm në trajtën e duhur të domosdoshmërisë së rrethanave e jo për interesa personale të kujtdoqoftë. Nuk mundet askush të pretendojë se po bënë më të mirën për subjektin politik të tij ose saj kur ndryshimet nuk i sheh përmes prizmes së frymës të mirëkuptimit të përbashkët.

Ne si LDK mund të ecim përpara sigurtë vetëm të përbashkuar rreth misionit dhe vizionit politik të subjektit që i takojmë, e duam, e i shërbejmë me besim në vlerat

autentike që ngërthen në vete, e në kuadër të interesit kombëtar e shtetror. Secila rrugë tjetër është vecse një qorrsokak politik, një aventurë jetëshkurtër në dallgët e politikbërjes partiake.

LOJALITET, DURIM, KURAJO

Këto tri vlera, shkronjat e para të së cilave koincidojnë edhe me akronimin e LDK-së, janë gurthemel i identitetit tonë politik. Secila prej tyre, në kuadër të filozofisë politike të elaboruar më parë, përfaqësojnë pjesë të pazëvendësueshme dhe të patjetërsueshme të AND-së së LDK-së.

Të jesh lojal ndaj një kauzë ka qenë dhe duhet të mbetet virtyt i të qenurit në LDK, përkundër krejt sfidave. Që nga themelimi i saj më 1989, kauza e LDK-së ishte shteti i lirë, i pavarur dhe demokratik, i Kosovës. Për shkak të lojalitetit ndaj kësaj kauze madhore kombëtare, LDK u bë besa dhe shpresa jonë për shtetësi. Edhe pse u luftua e u sfidua, LDK nuk u dorëzua. Ajo u bë urë mbi të cilën kaloi karvani i përpjekjeve popullore deri në mëvetësinë e vendit. U shkel e u baltos (shpeshëherë edhe nga brenda), por nuk u gjunjëzua! U nda e u ribashkua, por asnjëherë nuk u shua!

Durimi është urtësi politike e LDK-së. Këtë lojalitet ndaj kauzës së shtetit të Kosovës, LDK e ruajti për shkak të durimit. LDK dha shumë! Nga gjiri i saj politik, dolën plot që bënë parti e lëvizje, iniciativa e grupe politike. Por, LDK qëndroi stoikisht. Qëndroi sepse kishte mision fisnik për shtetndërtimin e Republikës! Qëndroi edhe atëherë kur u vra e u shantazhua, u fy e u denigrua pa të drejtë! Qëndroi sepse barti barrën e vendit për bërjen e shtetit.

Por, përgjërësa ne mund të kemi lojalitetin ndaj një kauze dhe durimin për ta bartur barrën e përgjegjësisë për realizimin e kauzës në fjalë, është kurajo për të vepruar që ndërlidhë dh endërvepron më këto dy vlerat e para për të garantuar suksesin. Asnjëherë nuk mjafton të kemi vetëm ndjesinë për dhembshuri; na duhet edhe kurajo për veprim. Vetëm atëherë, ne ecim suksesshëm drejt objektivave tona politike e të tjera.

REFORMA SI ZHVILLIM

Sa herë që ndokush të flas për reforma, një pjesë e konsiderueshme e njerëzve fillojnë të mëndojnë për ndryshim. Shpeshëherë, ndryshimi është i padëshiruar. Realisht, në shumicën e rasteve, sidomos tek titullarët, ndryshimet bëhen vetëm atëherë kur janë domosdoshmëri.

Reforma që unë do e preferoja është zhvillimi. Zhvillimi i ka dhimbjet e veta, por domosdoshmërisht sjellë edhe sukseset e veta.

Nën dritën e filozofisë politike dhe vlerave themeltare të LDK-së të elaboruara më lartë, në vijim do paraqes shkurtimisht konceptin bazë të reformës si zhvillim për LDK-në:

Anëtarët si Hisedarë

Është themeltare për mua vendimmarrja gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënja. Përgjegjshmëria para anëtarëve të LDK-së duhet të jetë e barazvlefshme me llogaridhënjen para strukturave e organeve të partisë. Të dyja këto koncepte fuqizohen skajshmërisht kur anëtarët e LDK-së janë ata që përcaktojnë jo vetëm liderin e partisë, por edhe liderin e degës, nëndegës, përmes votimit të drejtpërdrejtë. Në linjë me sistemin e "primaries" në demokracinë partiake në SHBA, do jenë anëtarët e regjistruar të LDK-së ata që përmes votimit të drejtpërdrejt do zgjedhin kryetarin e partisë, dhe kryetarët e degëve e të nëndegëve të partisë. Në këtë mënyrë, ne e sjellim vendimin më të rëndësishëm për LDK-në direkt në duartë e vet anëtarëve të saj.

Organet si Forume Politikbërëse

Votimi i drejtëpërdrejtë i kryetarit të partisë si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal nga anëtarët e LDK-së nuk e shuan rëndësinë e kuvendeve dhe kryesive e as Këshillit të Përgjithshëm. Kuvendet do e kenë rolin e vet statutar në zgjedhjen e anëtarëve të KP-së dhe të Kryesive, ndër të tjera. Kurse, KP dhe Kryesia do i

përkushtohen politikbërjes në nivel kombëtar në secilën sferë – Kryesia si organ vendimmarrës dhe ekzekutiv për aktivitetet e përhershme të LDK-se, e KP si organ vendimmarrës për tema madhore që kanë të bëjnë me partinë.

Kandidatët për Zgjedhje Përcaktohen nga Anëtarësia

Është në linjë me sistemin zgjedhor brendapartiak në SHBA dhe shumë demokraci tjera që kandidatët e partisë për garë lokale apo nacionale – pra për Kryetar Komune dhe Deputet – të përcaktohen nga vet anëtarët e LDK-së përmes një procesi zgjedhor të brendshëm ("primaries"). Kjo do ndihmonte shumë në përcaktimin e kandidatëve që kanë potencialin më të madh për të arritur fitoret elektorale, dhe njëkohësisht, do përjashtonte mundësinë e nominimeve për gara të individëve që mund të favorizohen nga kryetarët e degëve apo kryetari i partisë, por të cilën nuk e gëzojnë përkrahjen apo preferencën e antëtarësisë.

Mërgata Përfaqësohet Dinjitetshëm

Roli i mërgatës, jo vetëm për LDK-në, por edhe për krejt Kosovën, është i pakompenzueshëm. Por, për të inkuadruar mërgatën më shumë në LDK, pos përkrahjes së vazhdueshme të degëve në mërgatë nga qendra, një pozitë e Nënkryetarit të LDK-së do rezervohet për ta, si dhe të paktën 10% e listës për zgjedhje parlamentare do rezervohet po ashtu për të nominuar nga degët në mërgatë. Tutje, në momentin që LDK do vinte në qeveri, të paktën një pozitë Ministrore apo dy pozita të Zëvendësministrave do përcaktoheshin nga anëtarësia dhe degët tona në mërgatë.

Forumi i Rinisë dhe Forumi i Gruas me Linja të Veçanta Buxhetore

Të dyja këto forume do kenë linja të veçanta buxhetore dhe autonomi të plotë të vendimmarrjes buxhetore në kuadër të buxhetit partiak. Në këtë mënyrë, do mundësohej edhe rritja e aktiviteteve tek të dyja forumet, por njëkohësisht, edhe rritja e llogaridhënjes dhe përgjegjshmërisë karshi objektivave të paracaktuara partiake.

Akademia Politike

Në bashkëpunim me partitë simotra nga EPP dhe fondacionet e tyre përkatëse, LDK do organizojë programe të rregullta trajnimi politik dhe të politikbërjes publike të hapura për pjesëmarrje nga secili anëtar i LDK-së.

Kampet Rinore Politike

Të paktën dy herë në vit, LDK do organizojë kampe politike disaditore për të rinjtë. Temat e diskutimit, trajnimit, dhe punëtoritë përkatëse do jenë të ndërlidhura me ngritjen e shkathësive sociale dhe të lidërsipit.

e-LDK

LDK do të krijojë dhe funksionalizojë portalin vet digjital përmes së cilit do pasqyrohen të gjitha aktivitetet e LDK-së dhe zyrtarëve e të zgjedhurëve të saj. Portali në fjalë do shërbejë edhe si mjet i komunikimit të drejtpërdrejt të anëtarësisë me zyrtarët dhe të zgjedhurit e LDK-së. Pjesë e portalit do jetë edhe databaza e anëtarësisë, ku secili anëtarë do mund të krijojë profilin vet dhe do mund të lidhet e komunikojë edhe me anëtarët tjerë. Portali do ofrojë edhe forume diskutimi online për tema të caktuara për të gjithë anëtarët.

Zyre për Deputetët në Vendet e Tyre

Edhe pse Kosova është vetëm një zonë zgjedhore, historiku i zgjedhjeve parlamentare na tregon se shumica dërmuese e deputetëve numrin më të madh të votive e marrin nga vendet prej nga vijnë. Andaj, në bashkëpunim me degët përkatëse, LDK do ofrojë ambiente pune (zyre) për deputetët në vendet e tyre, ashtu që ata të jenë në shërbim të qytetarëve, respektivisht votuesëve të tyre. Afërsia e deputetëve me elektoratin e vet në vendet e veta kryesisht krijon lidhshmëri më të fuqishme dhe siguron përkrahje të vazhdueshme për deputetët dhe partinë, respektivisht.

Afër Elektoratit

Jo vetëm në kohë zgjedhjesh, por gjatë gjithë vitit, LDK do ketë një orar të bashkëbisedimit me qytetarë. Zyrtarët e LDK-së, sikurse edhe të zgjedhurit e saj në nivel lokal e qendror, në fillim të secilit vit, do paraqesin orarin e takimeve me qytetarë për gjithë vitin. Këto takime do të bëhen të rregullta dhe obligative për t'u ofruar nga ana e zyrtarëve dhe të zgjedhurëve të LDK-së.

Mirënjohje dhe Vlerësim i Institucionalizuar

LDK do krijojë një rregullore të posaqme përmes së cilës do të përcaktojë dhe rregullojë ndarjen e titujve, medaljeve, dhe vlerësimeve tjera honorifike për aktivistët dhe kontributdhënësit e vet. Në selinë qendrore, LDK do përcaktojë një lokacion specifik të quajtur "HALL OF FAME" (Holli i Famës) ku do vendosën emrat e personave më meritore dhe të vlerësuar për të shërbyer si frymëzim për të tjerët dhe si vlerësim për kontributin e tyre.

Fondacioni Presidential Dr. Ibrahim Rugova

LDK do të bashkëpunojë ngushtë me familjen e Presidentit Rugova për të themeluar Fondacionit Presidential Dr. Ibrahim Rugova sipas modelit të fondacioneve presidenciale të SHBA-ve, pjesë e të cilit do të jetë edhe muzeu presidencial me artifaktet kryesore të Presidentit Rugova.

ORIENTIMET PROGRAMORE

“POVERTY TRAP” – KURTHI I VARFËRISË



Është primare për LDK-në, të flasim për zhvillimin ekonomik të Kosovës është të provosh të gjesh zgjidhjen aq shumë të kërkuar e të nevojshme për realizimin e kërkesës më prioritare të qytetarëve tanë, e cila është papunësia. Papunësia në Kosovë është jashtëzakonisht e madhe. Kjo ndërlidhet edhe me pamundësinë e shumë bizneseve të vogla e të mesme që të legalizojnë edhe ata pak punëtorë që realisht i punësojnë.

Nuk zgjidhet problemi i papunësisë përmes rritjes enorme të punësimeve të përkohëshme të ndërlidhura me grante qeveritare për projekte (shpeshëherë fantome), apo përmes investimeve publike në infrastrukturë që gjenerojnë vecse vende pune sezonale. Fatkeqesisht, ikjet kogja masive të të rinjëve nga Kosova, në aspektin statistikor e zvogëlojnë artificialisht numrin e të papunësuarëve në vend, por kjo është veçse një mashtrim optik për publikun. Realisht, kjo është tragjedi kombëtare.

Andaj, e vetmja zgjidhje e sigurtë dhe afatgjatë për çështjen e papunësisë në vend është zhvillimi i mirëfilltë ekonomik. Një vend mund të zhvillohet ekonomikisht dhe t'i ikë asaj që në disiplinën e zhvillimit ekonomik njihet si “poverty trap” apo “kurth i varfërisë” vetëm përmes rritjes endogjene të bruto produktit vendor. Kjo rritje do të

nënkuptonte edhe zvogëlimin e deficitit të madh tregtar, duke sjellë vendin në një stad të qëndrueshmërisë buxhetore.


Zhvillimi ekonomik i Kosovës është i realizueshëm. Por, kjo kërkon përkushtim dhe disiplinë të përpiktë fiskale dhe buxhetore nga qeveria e vendit, investime kapitale në sektorin e prodhimit përmes partneriteteve publiko-private, marrëdhënje të qëndrueshme me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe përmes krijimit të një **Fondi të Posaçëm Investiv për Diasporën**.

Fondi i Posaçëm Investiv për Diasporën është mekanizëm që do t'i ofronte mërgatës sonë mundësi investimesh në Kosovë përmes garancive bankare e shtetërore. Ky Fond do t'i siguronte afaristët nga mërgata jonë që idetë e tyre ndërmarrësore t'i realizonin në Kosovë, që kursimet e tyre t'i sjellnin në Kosove (duke iu ofruar atyre një rate interesi më të mirë se në vendet ku ata jetojnë).

Unë besoj në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe e shoh Fondin e Posaçëm Investiv të Diasporës si mekanizëm të favorshëm në këtë kuadër. Vetëm kështu zhvillohet Kosova!

Natyrisht zhvillimit të pergjithshëm ekonomik të Kosovës duhet t'i paraprijë një sistem juridik i bazuar në sundim të plote të ligjit. Siguria juridike është parakusht për të siguruar investime dhe zhvillim ekonomik.

PUSHTETE TË NDARA – PËRGJEGJËSI E PLOTË



Një nga problemet esenciale në vendin tone është mungesa e sundimit të ligjit. Realisht, krimi dhe korrupsioni vazhdojnë të lëndojnë shoqërinë tonë në vazhdimësi. “Shkon Lumezi, e vjen Elezi” është asgjë më shumë se një “Cinderella Story” por jo zgjidhje reale e problemit. “Lufta kundër korrupsionit” e proklamuar nga ata që i dhanë vulën e rrënjësimit krimin dhe korrupsionit në vend është vetëm se një tentim për të larguar akullin me borë.

Në të gjitha raportet e Komisionit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, për Kosovën e theksojnë mungesën e sundimit të ligjit si problem madhor të vendit. Ky problem vlerësohet edhe si një nga barrierat më të mëdha të vendeve në zhvillim dhe pengesë madhore për konsolidim të demokracisë.

Nuk ka shembull më të mirë të sundimit efikas dhe efektiv të ligjit sesa sistemi i tri degëve qeverisëse të SHBA-ve, të trija të pavarura nga njëra tjetra: Administrata (ekzekutivi), Kongresi (legjislatura), dhe Gjyqësori (sundimi i ligjit). Andaj, Kosovës i duhet një reformë e thellë dhe përmbajtësore për ndarjen e përgjegjësi në mes këtyre tri degëve të qeverisjes njëherë e mire: Qeveria, Parlamenti, dhe Gjyqësori duhet të jenë totalisht të pavarur në vendimmarrjen e tyre.

Nëse ne e kemi njëmend admirimin për Amerikën dhe demokracinë amerikane, atëherë, ne do të duhej që reformes së ndarjes së pushteteve t'i japim prioritetin dhe rendësinë e duhur. Pavarësia e këtyre pushteteve ofron themelin e domosdoshëm për fillim të zbatimit të sundimit të ligjit! Cdo bishtrim ndaj kësaj sfide është bishtrim ndaj tejkallimit të sfidës më madhore të vendit.

LDK do të qëndrojë për pavarësi të plotë të pushteteve; për sundim efikas dhe efektiv të ligjit për të gjithë pa asnjë dallim.

FONDI NACIONAL I EKSELENCES



Çështja e cilësisë në arsim në vendin tonë shpeshëherë ndërlidhet kryesisht me mungesën e infrastrukturës së duhur në objektet tona shkollore. Realisht, Kosova ka ndërtuar, rindërtuar, e renovuar një numër relativisht të shkollave në vend. Andaj, ajo që është shumë më e rëndësishme se infrastruktura në shkolla është ana tjetër e medaljes. Pra, problem më esencial është “software” i sistemit tone të arsimit, e jo aq “hardware”.

Reformat që janë provuar të bëhen në sistemin tone të arsimit jo veçse kanë dështuar, por në disa raste edhe e kanë denigruar arsimin tonë.

Neve na duhet të investojmë shumë më shumë në mësimdhënësit tonë – jo vetëm në aspektin formal të certifikimit të tyre – por në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre. Mësimdhënësit tanë realisht kanë qenë shtylla më e fuqishme e rezistencës sonë paqësore para luftës. Ata ishin guardian të shqiptarizmës. Sot më shumë se kurrë neve na duhet të investojmë tek mësimdhënësit tanë, gjithëherë duke nderuar dhe respektuar punën e atyre që me vetflim na mësuan neve në kohët më të vështira.

Sistemi jonë arsimor duhet të edukojë gjeneratat e reja, e jo vetëm t'i certifikojë ata me diploma – qoftë të shkollës së mesme, fakultetit, magjistraturës, apo doktoraturës. Ne sot kemi një inflacion titujsh akademik, por deficit të madh të vlerës akademike.

*Kosovës i duhet një reforme e avansimit të sistemit tone të arsimit sipas programit të “Center for American Progress” (Qendrës Amerikane për Progres), ku të paktën dy nga shtyllat kryesore të programit do duhej implementuar menjëherë: zhvillimi dhe avansimi i vazhdueshëm profesional për mësime dhe ndërlidhja e programeve studimore me nevojat e tregut. Këtu e shtojmë edhe **Fondin Nacional të Ekselencës**, nga i cili do përfitonin financiarisht, si stimulim, talentët tanë të rinjë në shkencë, kulturë, sport, etj.*

Unë besoj se Kosova mund ta përmirësojë cilësinë e arsimit. Kosova mund të shkelqejë në PISA. Kosova mund dhe do të ketë arsim që edukon breza të tërë.

DIPLOMACI QË PËRFAQËSON DINJITESHËM



Se diplomacia jonë është kthyer në një sistem punësimi për militantë politik është konstatimi më bazik i mundshëm. Cdo ditë që ne vonohemi në reformimin e thellë të këtij sistemi, është ditë e humbur për Kosovën në afirmimin e saj ndërkombëtar. Ideja se neve të gjitha punët e jashtme na i kryen Amerika, kryesisht, dhe aleatët tjerë kryesorë, është jo vetëm se vetshkatërruese, por bile edhe ofenduese për Amerikën dhe miqtë tjerë.

Ka mbi dy dekada që unë kam punuar intensivisht me lobin shqiptaro-amerikan, respektivisht Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane, nën udhëheqjen e Kongresistit Joe DioGuardi dhe znj. Shirley Cloyes DioGuardi, dhe gjatë kësaj kohe kemi pasë rastin e mirë, që të bashkëpunojmë me shumë figura kyçe të politikës amerikane duke përfshirë edhe Joe Biden, në fushatën presidenciale të së cilit isha inkuadruar para se të kthehesha në Kosovë për garën për Parlamentin e Kosovës më 2019. Nga kjo përvojë kam mësuar shumë. Punët tona të shtëpisë janë detyrim yni e jo i Amerikës. Amerika ka nevojë për një shtet mik dhe aleat e jo për një shtet vasal e as servil.

Diplomacia jonë, urgjentisht, duhet të bëhet vatër e punës së qindra vajzave e djemëve tanë të rinjë, profesionistë të zotë, shumë prej të cileve janë shkolluar në universitetet më me nam në SHBA e Evropë, e të cilët pos anglishtës flasin të paktën edhe një apo dy gjuhë tjera.

Vend të posacëm këtu zë edhe përkrahja institucionale që qeveria jonë e ardhëshme duhet t'ia bëjë diplomacisë publike. Diplomacia publike ka qenë totalisht e nënçmuar dhe fare e pakonsideruar nga qeveritë e kaluara. Por, realisht, diplomacia publike na ka shërbyer shumë më shumë se vet MPJD. Sukseset e diplomacisë publike kryesisht u dedikohen diasporës sonë; mergimtarëve tanë të vullnetit të mire që asnjëherë nuk iu ndanë Kosovës dhe atdhedashurisë për vendin e kombin tonë.

*Kosova duhet që në kuadër të MPJD të implementojë një **Program Special të Diplomacisë Publike** që do të bashkërendonte por edhe do të financonte projekte të fushës së diplomacisë publike me interes kombëtar e shtetëror për vendin. Ky program do të sjellte shumë më shumë benefite për vendin por edhe për shumë çështje të jashtme të Kosovës. Ky program do krijonte edhe postet e njohura si “**Ambassador-at-Large**” për tema të caktuara të interesit shtetëror për Kosovës, si psh., për ndryshimet klimatike, të drejtat e njeriut, harmoninë fetare, etj.*

MULTIETNICITET QE FUNKSIONON



Përgjithësisht, ne të gjithë jemi të paknaqur qoftë me mënyrën se si është përcaktuar flamuri ynë shtetëror apo edhe hymni i Kosovës. Por, kjo nuk nënkupton që këtë paknaqësi ta shprehim përmes mosnjohjes së këtyre simboleve. Në fund të fundit, këto simbole, ashtu sic janë, emblematizojnë shtetin tonë për të cilin kemi sakrifikuar shumë si popull.

Barrën më të madhe për të ardhë deri tek pavarësia e vendit e kemi paguar me Planin e Ahtisaarit. Tash, ne negociatet me Beogradin po vazhdojmë të rrëshqasim edhe përtej kësaj kosto.

Neve na duhet një Kosovë që funksionin si tërësi. Le të jetë kjo Kosovë multietnike, sepse dihet botërisht të shumica absolute e popullatës sonë janë shqiptarë etnik. Andaj, si shumicë absolute ne do t'i njohim dhe respektojmë minoritetet.

Kosova më duket e lodhur nga ajo që quhet diskriminim pozitiv ndaj ofertës që kanë bërë institucionet e Kosovës, për serbët e Kosovës. Gjerësa ky "diskriminim" nuk është parë ansjërherë si pozitiv nga serbët por është refuzuar në menyrë permenente, kam përshtypjen se serbëve të Kosovës nuk iu intereson multietniciteti.

Multietniciteti që të funksionojë duhet pasur besim, gjë e cila nuk mund të rregullohet vetëm me norma e ligje kushtetuese. Që serbët ta ndjejnë Kosovën si vendin e tyre, që i mbron dhe iu ofron atyre shtetin e përbashkët e të sigurtë, ata duhet të lirohen nga tutelazha e Beogradit.

Vetëm në bashkëpunim strategjik e të ngushtë me SHBA-të, Kosova mund dhe do t'ia dalë t'i jap fund procesit tanimë të stërzgatur të dialogut me Serbinë, përmes një marrëveshje ligjshmërisht obligative që ofron njohje për Kosovën dhe assesi nuk dëmton apo cënon funksionalitetin, sovranitetin, dhe integritetin territorial të Kosovës përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

KULTURË QË SHPËRFAQË VLERË E TRADITË



Tradita dhe vlerat tona kombëtare janë esenciale në ndërtimin e qenjes tone. Zhvillimi i duhur i kulturës është sistemimi që duhet bërë vlerave tona dhe traditave tona kombëtare. Të promovosh kulturën e një vendi është të shpërfaqësh vlerat dhe traditat e popullit të atij vendi kudo që të jetë e mundur.

Shpeshëherë flitet se interesimi i kosovarëve për lexim, për të shkuar të teatër, apo për të ndjekur një koncert të muzikës klasike, është shumë i ulët. Por, ne duhet patur parasysh edhe anën tjetër të medaljes – sa është investuar në përkrahje të zhvillimit të kultures, në përkrahje të botimeve e promovimeve të autorëve të rinjë e atyre tanimë të dëshmuar, të realizimit të shfaqjeve në teatro apo koncerteve të muzikës burimore?

Ende sot e kësaj dite, ne ballafaqohemi me problemin e madh të Teatrove Profesionale të Qyteteve të Kosovës, sepse as komunat përkatëse e as qeveria nuk marrin përsipër përkrahjen ndaj tyre. Një vend pa kulturë është sikur një lis pa gjethë!

*Kosovës i duhet që sa më pare të themelojë një agjensi të vecantë për mbështetje të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të kulturës në vend, një **Këshill Nacional për Kulturë e Art**, ndoshta, ngjashëm me atë që e ka Anglia, psh. Ne kemi një Ministri të Kulturës, Rinise dhe Sportit, e cila realisht është e ngarkuar me politikbërjen publike në këtë kuadër. Neve na duhet një Këshill Nacional për Kulturë e Art që do të ndihmontë fuqishëm në zhvillimin më të houshëm të kulturë sonë. Ne kemi shumëçka që t'i ofrojmë botës, sikur që i kemi ofruar, Rita Ora e Dua Lipa, e shumë të tjerë.*

“MOS U BËFSH PËR DOKTOR”



“Mos u bëfsh për te mjeku,” thuhet të jetë bërë një postulat famëkeq për qytetarët e Kosovës. Është e kuptueshme që askush me dëshirë s'do të donte të shkonte në vizitë tek mjeku, por vizitat në spitale e ambulance janë domosdoshmëri sa here që ne ndjejmë përkeqësim shëndeti. Arsyeja kryesore që na bënë neve të shkojmë tek mjeku është nevoja për shërim. Pra, neve na duhet një shëndetësi që shëron.

Ajo që kemi parë deri më tani ka qenë shpeshëherë veçse kamuflim i gjendjes së stërkequr në sistemin tonë shëndetësor. Një emergjencë e renovuar me pllaka të reja, e mure të lyera bukur, dhe një TV e pushimore për pacientë, është gjë e mirëseardhur por jo e mjaftueshme për një shëndetësi që shëron.

Edhe në këtë aspekt, ngjashëm sikur në sistemin arsimor, kryesisht problemi është shikuar si dicka që mund të zgjidhet me ripërtritjen materiale të sistemit. Jo domosdoshmërisht. Përveç kësaj, në sistemin tonë shëndetësor duhet investuar shumë më shumë në ndryshimin e perceptimit të punonjësve shëndetësor kundrejtë

pacientëve dhe anasjelltas, në kulturën e shërbimit, si dhe në vlerësimin që duhet dhënë mantelbardhëve.

Kanadaja, një vend mik yni, vlerësohet botërisht për një system shëndetësor cilësor dhe funksional. Kanadaja ofron një shëndetësi publike që shëron. Sistemi shëndetësor kaandez financohet nga qeveria, përmes fondit publik të sigurimit shëndetësor që paguhet direkt nga taksapaguesit vendas. Kosova, duke qenë një vend shumë me l vogël se Kanadaja, ka mundësi të shumeta që të realizojë një system shëndetësor që shëron duke sjellë në dritë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe të njeftin duke e vënë në dispozicion të financimit direkt të sistemit tone shëndetësor. Implementimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është stërvonuar tanimë. Kjo do të mund të bëhej në bashkëpunim me një vend sic është Kanadaja duke marrë parasysh përvojën e tyre, e bile edhe ndihmën e tyre buxhetore në këtë drejtim, pasi që jemi vende shumë miqësore.

Kosova mund të ofrojë një shëndetësi që shëron. Këtë mund ta bëjmë bashkë, duke nderuar matelbardhët për punën e tyre, si dhe duke respektuar e ndihmuar pacientët me nevojat e tyre, në çdokohë.

SPORTI – YLLI ME MË SHUMË DRITË NË KOSOVË



Nëse ndokush i ka dhënë Kosovës imazhin që e meriton, atëherë atë e kanë bërë sportiestët tanë të dalluar. Realisht, yllëzimi i Kosovës në botë s'ka si mos të ndërlidhet me emrin e kosovares së parë në histori që mori medaljen e artë në Lojrat Olimpike, Majlinda Kelmendi. E si Majlinda, Kosova jonë ka plotë të tjera. Atyre vetëm duhet dhënë shancën; fytyrën do na e zbardhin patjetër.

Sporti nuk mund të konsiderohet vetëm temë zgjedhjesh. Sporti është mënyrë e jetesës për shumëkë. Sporti është begatim i shoqërisë; është kulturë dhe traditë e një populli.

Neve na duhet të risim jo vetëm përkrahjen buxhetore, por edhe angazhimin politik që sporti të bëhet pjesë e pandashme e agjendës qeveritare. Politikat publike të ndërlidhura me sportin duhet të jenë politika që marrin primat në adresimin e çështjeve të rinisë dhe profesionistëve sportiv.

*Përmes **Fondit Nacional të Ekselencës** do t'i japim mbështetjen meritorë sportiestëve tanë të dalluar, duke i stimuluar e përkrahur ata financiarisht që të arrijnë majat e suksesit jo vetëm në vend, por edhe në arenën ndërkombëtare.*

Sportistët e Kosovës bëhen kampionë. Neve na bëjnë nder kampionët që e zbardhin emrin e shtetit tonë nëpër botë.

PROGRAME SOCIALE QË SJELLIN VETBESIM E JO LËMOSHË



Grupet e marginalizuara, pensionistët, familjet që jetojnë në varfëri, njerzit më nevoja të vecanta janë grupacionet e popullit që meritojnë një trajtim dinjitoz e të vecantë. Ata nuk duhet të shihen si barrë për shoqërinë, por si një sfidë që shoqëria duhet ta përqafojë.

Listat e gjata me përfitues të benefiteve sociale në Kosovë janë lista mëshire e lëmoshe. Kosovës sot më shumë se kurrë i duhen programe sociale që u japin vetbesim këtyre kategorive e jo vetëm lëmoshë.

Neve na duhet ta reformojmë sistemin e programeve sociale ashtu që njerzit e disa kategorive te caktuara të kenë mundësi të dalin nga këto skema dhe të bëhen të vetqëndrueshëm. Programet që mund ta realizojnë këtë qëllim janë programet e trajnimeve të posaqme për punë, aftësimit për shkathtësi që i duhen tregut të punës.

*Neve na duhet të krijojmë një **Program për Punësim Ndihmues**, të ngjashëm me programet e njohura në SHBA e*

Kanada si “apprenticeship” të cilat ndihmojnë njerzit e kategorive të ndryshme të punësohen në pozita tek të cilat ata mund realisht të japin kontributin e tyre. Ky program do t’i ndihmonte punëmarrësit të aftësohej për një punë të caktuar, por edhe do të subvenciononte pjesërisht punëdhënësin për pagën e punënjësit.

Vetëm në këtë mënyrë, Kosova realizon programe sociale që sjellin vetbesim e jo vetëm lëmoshë, si dhe ofrojnë dinjitet për të gjithë pa asnjë dallim.

BEREQETI JONË, NGA TOKA JONË



Kosova ka një sipërfaqe me mbi 60% të tokës pjellore e cila mundëson zhvillimin e bujqësisë dhe e cila ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Më parë se sa të mendojmë që kjo tokë duhet punuar dhe kultivuar, duhet bërë plane, ligje të zbatueshme, që mbrojnë tokat pjellore të mos tkurrën.

Në interesin nacional një elitë e mirëfilltë intelektuale do të mendonte që tokat tona pjellore duhet të mbrohen aq sa edhe kufinjtë e vendit.

Mbrojtja e tokave pjellore del të jëtë një nga projektet më sensitive që kanë të bëjnë me projektet afatgjata të mirëqenjes së vendit tonë. Te mbrosh tokën e bukës sot dhe të përkrahësh substancialisht fermerët dhe agrobiznesin tonë, është të kesh nesër të sigurtë ardhmërinë edhe të gjeneratave pasardhëse.

Kosova duhet të fus në fokus si prioritet çështjet që kanë të bëjnë me politikat bujqësore ashtu që hambari ynë elementar ushqimor të mbushet me produkte vendore e jo nga importi.

Keqperdorimi i fondeve qeveritare në emër të bujqësisë, është një nga dëmet më të mëdha që i është bërë sektorit bujqësor në Kosovë, duke subvencionuar militantët partiak të cilët pas një kohe të shkurtë edhe ia kanë ndërruar destinimin këtyre fondeve.

Kosovës i duhet një bujqësi e zhvilluar dhe e qëndrueshme, e cila do të përkrahej dhe stimulohej nga Qeveria përmes politikave agrare të drejtuara kah fermeri i vertetë, dhe jo ai fantom.

SHËNIME BIOGRAFIKE

Shënime Biografike:

DR. FATON BISLIMI



Deri më tani, edhe pse në moshë ende të re, Faton Bislimi ka arritur që të gjitha ëndërrat dhe premtimet e tij t'i kthejë në realitet – dhe jo vetëm për ambiciet e veta, por edhe për të shumë të rinjëve tjerë të Gjilanit e Kosovës. Lindur e rritur në Gjilan, ai ka kryer shkollimin universitar në dy fakultete njëkohësisht (shkenca kompjuterike dhe matematikë), me bursë të plotë, në kohë rekorde prej vetëm tri viteve në Universitetin e Teksasit në SHBA. Menjëherë pas diplomimit nga universiteti, ai është bërë

studenti i parë më i ri i pranuar në Shkollën Postdiplomike të Qeverisjes “John F. Kennedy” të Universitetit më prestigjioz në botë, Harvard, për të magjstruar në Administratë Publike dhe Zhvillim Ekonomik Ndërkombëtar, ku është nderuar me titullin me të rëndësishëm të kësaj shkolle, Kennedy Fellow. Gjatë studimeve në Harvard, kur ne të njejtin program ishte edhe Vuk Jeremiq, Fatoni u bë i njohur për ballafaqimet e tij me Presidentin Tadiq të Serbisë asokohe, sa që në Librin e Gjeneratës të Harvardit, Fatoni njihet për “grilling the Serbian President” (për përzhitjen e Presidentit Serb). Pas disa viteve pune profesionale si profesor universitar dhe menaxher në UNDP në Kosovë, ai iu kthye shkollimit të mëtutjeshëm duke bërë edhe një magjistraturë në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Dalhousie University në Halifax, Canada, ku edhe ligjëroi në dy universitete atje, dhe në verën e vitit 2020 ka marrë titullin e Doktor Shkence në Shkenca Politike.

Në përkrahje të të rinjëve me ambicie për arsimim kualitativ, Fatoni ka themeluar dhe udhëheq fondacionin e tij arsimor joprotitabil përmes së cilit iu ka mundësuar dhjetra të rinjëve të shkollohen në SHBA e Kanada. Disa nga këta të rinjë sot janë yje që po i zbardhin fytyrën gjithë

Kosovës, duke shkëlqyer si më të zotët në punën e tyre në korporatat më të mëdha në Amerikë si në Microsoft, Facebook, Intel, West Point, etj. Fatoni është pjesëmarrës dhe ligjerues i shumë konferencave ndërkombëtare, si dhe fitues i një sër çmimesh ndërkombëtare akademike, për lidhshëm, etj., është edhe anëtar i plotë dhe anëtar nderi i shumë organizatave ndërkombëtare e forumeve botërore.

Përvoja e tij profesionale është majft e suksesshme dhe e larmishme. Fatoni ka përvojë edhe në majtën institucionale të administratës së SHBA-ve, në Kongresin Amerikan, gjejtësisht në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë të Kongresit. Gjatë qëndrimit në SHBA, ai ka krijuar lidhje të mira, gjatë punës për çështjen kombëtare shqiptare, me shumë personalitete të shquara amerikane.

Më 2019, Fatoni është bërë Anëtar i Komitetit Strategjik Këshilldhënës për Diplomaci Qytetare pranë German Marshall Fund of the US, si dhe shërben si ekspert në Taskforcën për Migrim pranë THINK20 në kuadër të G20.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, Fatoni ishte bartës i listës së LDK-së në Gjilan, dhe mandej kishte shërbyer në pozitën e Shefit të Kabinetit të Kryetarit. Paraprakisht, nga viti 2015, shërbeu edhe si Koordinator për Marrëdhënje Rajonale në Zyrën e Kryetarit të Gjilanit. Para se të merrte mandatin e parë si Deputet, Fatoni ishte pjesë e ekipit të Joe Biden në fushatën e tij presidenciale “Biden 2020”.

Fatoni ka mëse dy dekada që ka bashkëpunuar me figurat më kryesore të politikës Amerikane përmes Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, dhe llogaritet njeriu me lidhjet më të drejtëpërdrejta me Washingtonin. Ai është i martuar dhe baba i tre fëmijëve.

Çmimet e Nderit dhe Akademike:

- *Letër Mirënjohje nga Kryetaria e Washington, DC*
- *Çmimi Presidencial për Arritje Jetësore “Presidential Lifetime Achievement Award 2018”, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Washington DC*

- *Marshall Memorial Fellow 2015-16, German Marshall Fund of the United States*
- *Anëtar i Përvjetshëm i Golden Key International Honor Society*
- *Bursa "Joseph Armand Bombardier" për Studime Doktorature nga Këshilli Kanadez për Kërkime në Shkencat Shoqërore*
- *Bursa Presidenciale e University of Alberta*
- *Bursa Presidenciale e Dalhousie University*
- *Certifikatë Kongresionale e Mirënjohjes, Komiteti për Marrëdhënje Ndërkombëtare, Kongresi i SHBA-ve, Washington, DC, USA*
- *Çmimi për Ekselencë Akademike dhe Lidërsip, Albanian-American Foundation, New York, USA*
- *Çmimi për Ekselencë Akademike, Organizata Kombëtare Shqiptaro-Amerikane, New York, USA*
- *Çmimi Ndërkombëtar për Lidërsip, Civic Concepts International, Pragë*
- *Çmimi për Arritje të Shkëlqyeshme Jetësore, Shoqata Kombëtare e Shkollarëve të Nderit të SHBA-ve, USA*
- *Çmimi për Arritje të Jashtëzakonshme në Poezi, Shoqata Ndërkombëtare e Poetëve, Florida, USA*
- *Çmimi për Arritje Jetësore Akademike, Shoqata Akademike e Nderit Alpha Lambda Delta, USA*
- *Çmimi Jetësor i Anëtarësisë, Shoqata Akademike dhe Shkollore e Nderit të SHBA-ve, Alpha Chi, USA*
- *Çmimi Ndërkombëtar "Who's Who" në mesin e Studentëve të Universiteteve Amerikane, Who's Who, SHBA*
- *Çmimi "Shkollat Pan-Amerikan", Akademia Amerikane e Arritjeve, USA*
- *Bursë e Plotë për Arritje Akademike dhe Merita, Texas Lutheran University, USA*
- *Bursa "Kennedy Fellowship", JFK School of Government, Harvard University, USA*
- *Çmimi Presidencial për Lidërsip, MPAID Class of 2007, Harvard University, USA*
- *Anëtar Nderi i Shoqatës Ndërkombëtare të Poetëve, USA*
- *Anëtar i Samitit Botëror të Rinisë, Bruksel, Belgjikë*
- *Anëtar Nderi i Shoqatës së Liderëve të Rinj të Traktatit të Atlantikut Verior, Romë, Itali*
- *Anëtar Nderi i Parlamentit Evropian për të Rinj, Paris, Francë*

Libra të Botuar:

- *Përmbledhje Detyrash nga Matematika për Klasët V-VIII, Prishtinë, 1998*
- *Në Rrugëtim me Kosovën: Tatëpjetat dhe të Përpjetat, Houston, 2006*
- *Newborn Kosova: Some Development and Public Policy Challenges, Houston/Prishtinë, 2009*
- *Kosova: Shteti, Sfidat, dhe Mundësitë, Houston/Prishtinë, 2012*
- *My Kosovo Experience: Perspectives on Europe's Newest State, Houston/Edmonton, 2013*
- *Politikbërja Publike në Kosovë, AUK, Prishtinë*
- *The Albanian Rescue of Jews During the Holocaust, New York, 2020*
- *The Quest for Albanian Freedom and the End of Yugoslavia, New York, 2021*
- *Përpjekja për Lirinë Shqiptare dhe Fundi i Jugosllavisë, Prishtinë, 2023*

Shkrime të Botuara:

- *Autor i dy kapitujve akademik në libra universitar të shkencave politike në anglisht të botuar në SHBA*
- *Autor i dhjetrave shkrimeve dhe artikujve nga fusha të ndryshme sociale e ekonomike, të botuara në shtypin shqiptar dhe atë amerikan*
- *Autor i një punimi inovativ në Matematikë, botuar nga revista matematikore Die Wurzel, Gjermani*
- *Ligjerata dhe Prezantime në Konferenca Ndërkombëtare: - Ligjërues në mëse 20 konferenca ndërkombëtare akademike në Evropë, SHBA, Kanada, Meksikë, etj.*



Bislimi, DioGuardi, Dr. Rugova



Presidenti Biden dhe Bislimi

KONTAKTI:

Email: faton@bislimi.org

Web: <http://faton.bislimi.org>

Facebook: [@FatonBislimi43](#)

